



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.767/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit Bashkim Elshani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gllogocit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.767/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit Bashkim Elshani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gllogocit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për Kuvendin Komunal Bashkim Elshani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Gllogoc, në të cilën pretendon se duke pasur parasysh se në bazë të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja del se vota ime nuk figuron fare në qendrën e votimit ku unë votoj me numër 0309E/01, 0309E/02R dhe 0309E/03R, gjithashtu nuk figurojnë votat e disa personave të cilët kanë votuar me vullnetin e tyre për mua dhe këtu lind dyshimi se vota ime është ose është keqpërdorur.

Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa 34 votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për Kuvend Komunal Bashkim Elshani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Gllogoc, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet: 0309E/01R, 0309E/02R dhe 0309E/03R në Gllogoc.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklaratat e dorëzuar për VV-të e vendosura në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në ato VV, po ashtu për Panelin është e qartë se në këto VV kandidati në fjalë ka pasur vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në VV e vendosur në pikën -I- të dispozitivit nuk i ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota se sa janë publikuar në rezultatit përfundimtar, prandaj u vendos si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.767/2021 më datën 05.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.